



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI, AMBASADORIT VINCENZO DEL MONACO NË KONFERENCËN VIII VJETORE PËR MEDIAT NË EVROPËN JUGLINDORE “GAZETARIA NË KOHË KRIZE”

11 tetor, Tiranë

E nderuar Zonja Përfaqësuese, Shkëlqesia Juaj Kryeministër, Shkëlqesi, të nderuar pjesëmarrës, zonja dhe zotërinj!

Jam i nderuar t’ju drejtohem në këtë konferencë të rëndësishme, me kaq shumë folës të nivelit të lartë dhe me publik kaq të kualifikuar. Përshëndes secilin prej jush, si ata që ndodhen në këtë sallë edhe ata që po marrin pjesë nga interneti.

Ngjarjet kuptimplota nuk ndodhin rastësisht. Ato nisen nga një vizion dhe shoqërohen me shtysën e qëllimit dhe me vendosmërinë për ta synuar këtë të fundit. Më lejoni t’i shpreh mirënjohjen zonjës Përfaqësuese të Lirisë së Medias, koleges sime Teresa Ribeiro, për mbështetjen e përzemërt për organizimin e konferencës së sotme këtu në Tiranë, si dhe për lidhshimin e fortë. I shpreh mirënjohje edhe SH.T.Z. Kryeministër Edi Rama për mbështetjen e menjëhershme dhe për angazhimin personal. Ngjarjet e mëdha mbështeten gjithashtu në ekipe të sprovuara dhe falënderimet u shkojnë të gjitha ekipeve që u morën me punën përgatitore, nga ekipi i Vjenës te misionet simotra të OSBE-së në rajon, dhe patjetër edhe ekipit tim.

Hera e fundit që kjo konferencë rajonale u organizua në Shqipëri ishte në vitin 2013. Nëse mundem të përmend një aspekt personal, viti 2013 ishte viti kur erdha për herë të parë në këtë vend kaq të bukur dhe që prej asaj kohe *dashuria ime për popullin shqiptar* vazhdon. Përparimi mbresëlënës që Shqipëria ka bërë ndërkohë në shumë fusha vetëm se e rrit respektin që kam për të.

Tani më lejoni të ndaj me ju disa komente për programin e dy ditëve në vijim. Gazetaria në kohë krize është fatkeqësisht titull shumë i goditur. Në një farë mënyrë, kriza po kthehet në “gjendjen tonë normale”. Pjesëmarrësit që po na ndjekin nga interneti na kujtojnë kufizimet me të cilat përballemi ende si pasojë e pandemisë COVID-19. Nuk do të përsëris këtu se si pandemia ndikon te funksionimi i institucioneve demokratike. Aktualisht, po përjetojmë një numër të qenësishëm krizash, si brenda dhe jashtë zonës së OSBE-së. Qoftë në “kohë të mirë”, në kohë krize, apo në kohë sfidash, gazetaria vijon të jetë element thelbësor i çdo rebusi demokratik, si edhe shtysë e jashtëzakonshme e përparimit shoqëror.

Prandaj, qëllimi i kësaj konference është të zhvillojmë një debat të hapur dhe profesional për potencialin dhe sfidat e tablosë së medias. Ne duam të hedhim shikimin përpara dhe, duke qenë

se kjo është nismë e OSBE-së, ne duhet të mbajmë vështrimin te tabloja e gjerë. Në sytë e mi, tabloja e gjerë do të thotë të vendosësh të parët individët, të punosh për të pasur shoqëri të **hapur** dhe të japësh kontribut për të pasur rend ndërkombëtar të sigurt. Dhe, në këtë pikë, media ka rol të epërm. Media është objektiv që duhet mbështetur në vetvete për arsye të cilat i njohim shumë mirë dhe nuk ja vlen t'i radhisim përsëri. Por mbase mbi të gjitha media duhet parë si sinaps shoqëror, si mundësues dhe si mjet që lidh shtresat shoqërore, institucionet, aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë dhe qytetarët.

Le t'u hedhim një sy shifrave: po të krahasojmë Evropën Juglindorë të sotme me atë të 20 viteve më parë është e dukshme se përparimi i medias është i padiskutueshëm. Me popullatë prej afro **18 milion qytetarësh**, ky rajon ka larmi shumë të madhe të organeve mediatike: rreth **3 500** organe mediatike që veprojnë aktualisht, normë depërtimi të internetit **ndërmjet 80 dhe 90%**, dhe **10 departamente gazetarie në universitete**.

Të paktën në parim, këto shifra tregojnë liri të përgjithshme të medias, zonë ku informacioni qarkullon pa u penguar dhe ku gazetarët ndërlidhen më njëri-tjetrin. Nuk është rastësi që Prezenca e OSBE-së në Shqipëri po zhvillon, paralelisht me këtë konferencë, një takim të Shtigjeve Rinore, program ky që synon të sigurojë ndërlidhje edhe për gazetarët e rinj. Ne duam që të rinjve t'u dëgjohet zëri në lidhje me mënyrën se si media formëzon jetët e tyre, jetët tona. Dhe dëshiroja që ta bënim këtë diskutim këtu në Tiranë, ku vitin tjetër do të zhvillohen veprimtaritë në kuadër të Kryeqytetit Rinor Evropian.

Kjo liri e përgjithshme e medias nuk duhet marrë asnjëherë dhe askund si e mirëqenë. Dhe kur dalin pengesa, ato duhet të trajtohen me shpejtësi dhe me seriozitet. **Për shembull, ne duhet të sigurohemi që gazetarët të kenë mundësinë të punojnë në mjedis lejuar, të sigurt dhe që parimisht ofron qasje të lirë tek informacioni. Duhet të mbështesim gazetarinë që bazohet te faktet, të prapësojmë me vendosmëri lajmet e rreme dhe të sigurohemi për pavarësinë e gazetarëve nga kontrolli i pronësisë mbi median. Po flas për një mjedis që pasqyron realitetin e sotëm, larminë shoqërore dhe pluralizmin.**

Më lejoni tani të jap disa mendime rreth disa prej paneleve të tjera. Thelbi është që gazetaria është partnere strategjike e institucioneve shtetërore dhe e qytetarëve në kuadër të përpjekjeve për të çliruar shoqërinë, për t'u përballur me polarizimin dhe për të ndërtuar sigurinë. Nuk është detyrimisht "ndarje e re e punës". Po mendoj në fakt që mbase nuk mjafton thjesht të reflektojmë për një të vërtetë kaq të madhe.

Le të bëjmë një hap pas dhe të hedhim përsëri vështrimin te tabloja e gjerë. Kur shqyrtojmë dinamikën e sotshme, ne shohim dy botë të ndryshme. E para është botë me kufij kombëtarë; është bota që na kanë mësuar në shkollë, të paktën në kohën time; pra, rezultat i marrëdhënieve klasike ndërshtetërore me karakter vestfalik. E dyta është botë me një numër të paprecedent rrjetesh, e ashtuquajtura botë e "lidhur". Është bota që shohim prej hapësirës falë korridoreve të dritës; bota e platformave dixhitale.

Facebook-u për shembull ka **2.85 miliardë përdorues mujorë në të gjithë botën**, shifër e cila tejkalon dyfishin e popullatës në rajonin e OSBE-së (rreth **1 miliard e 289 milionë banorë**). Vetëm Instagram-i me **një miliard përdorues në të gjithë botën** i afrohet numrit të shtetasve që jetojnë në të gjithë rajonin e OSBE-së.

Këto shifra janë pasqyrë e forcës dhe e potencialit që kanë bota e lidhur, individët, por edhe gjigantët e platformave të reja dixhitale. Nuk mjafton në vetvete vetëm mundësia për t'u lidhur që njerëzit vërtetë të lidhen. Për të lidhur njerëzit na duhet t'u japim atyre një ndjesi qëllimi, dhe sërish kemi shumë nevojë për median, për median e mirë, që të na ndihmojnë për arritjen e këtij objekti madhor.

Aq më tepër në kohë krize, në një kohë kur ka boshllëk të përgjithshëm edhe me karakter etik, gazetaria cilësore është thelbësore për t'u ofruar individëve një busull për të lundruar në oqeanin e informacionit. Mediat bëhen **partnere** të domosdoshme të Shtetit për dhënien e kontributit për fuqizimin e njerëzve, për forcimin e rimëkëmbjes së kombit dhe patjetër edhe sigurisë për të gjithë. Kur them partner, e mendoj këtë në mënyrë strategjike, dhe kjo siguri nuk do të thotë që partneriteti përkthehet në harmonizim dhe mungesë kritike. Gjatë tri ditëve të fundit, kam pasur mundësinë të flas me gazetarët e rinj dhe kam besim se paneli i fundit për perspektivat e të rinjve do të na japë mundësinë për të marrë kontributin e tyre të vlefshëm për të ardhmen e medias në këtë rajon, rolin e tyre dhe se si e interpretojnë ata vetë-rregullimin e mediave. Dilema ndërmjet rregullimit dhe vetë-rregullimit është, në fakt, çështje mjaft kritike.

Besimi, ose ndoshta duhet të them mungesa e tij, është një tjetër koncept kyç. Pyes veten mos ndoshta kjo përbën një tjetër sfidë për këtë rajon. Me gjithë rëndësinë e vet, besimi qëndron në themel të çdo partneriteti ndërmjet institucioneve dhe medias, por edhe ndërmjet publikut dhe medias. Besimi në gazetarinë cilësore është një shigjetë e domosdoshme që kemi në dorë për t'u përballur më lajmet e rreme.

Në përfundim, do ta drejtoja kursoren nga ne, tek OSBE-ja dhe te kolegët e mi e trupit diplomatik. Cili është roli ynë këtu? Unë e besoj vërtet se ne kemi ende rol të jashtëzakonshëm për të luajtur që të ndihmojnë njerëzit të lidhen, që t'u japim atyre një ndjesi qëllimi, që të punojmë së bashku kundër polarizimit dhe për një botë më të sigurt. Diplomatët si bartës të një diplomacie të re në një botë të re. Kjo është pikërisht ajo që ne si OSBE po bëjmë: dëgjojmë pa përjashtim të gjithë bashkëbiseduesit dhe u mundësojmë një tryezë neutrale atyre që janë të gatshëm për t'u angazhuar në dialog, për të mbështetur politikën dhe për t'u lidhur. Duke qenë se ne vërtet besojmë në vlerën e madhe të shtuar që ka përfshirja e individëve në diskursin për sigurinë, ne kemi përqafuar qasjen me të gjithë shoqërinë bashkë dhe ne konkretisht përfshijmë të rinjtë dhe qasjen gjinore në të gjitha aktivitetet tona programore, dhe këtë e përshëndetën edhe të gjithë bashkëfolësit gjatë vizitës së fundit të Kryetares së Radhës të OSBE-së, pak ditë më parë.

Kjo është mënyra unike dhe gjithëpërfshirëse e të kuptuarit të sigurisë, e cila është e rrënjosur në të gjitha dokumentet tona themelore dhe e cila përkthehet në veprimtari të përditshme kudo ku ka mision të OSBE-së që punon në terren.

Faleminderit!